

**Prishtinë: 11/07/2007**  
**Kodi i ZRRE: D\_058\_2007**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:**

1. Nenet 15.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
2. Nenet 13.2 dhe 38.7 të Ligjit për Energjinë Elektrike, dhe
3. Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (tani e tutje KOSTT) për miratimin e Dispozitave Kalimtare për Kodin e Matjes dhe Kodin e Rrjetit.

Në seancën e mbajtur më 11 korrik 2007 nxjerrë këtë:

**VENDIM**

**Për Miratimin e Aranzhimeve Kalimtare për Kodin e Matjes dhe Kodin e Rrjetit.**

1. Në Qershor të Vitit 2007 KOSTT-i ka ushtruar kërkesën për miratimin e **Dispozitave Kalimtare për Kodin e Matjes dhe Kodin e Rrjetit.**
2. ZRRE ka shqyrtuar, plotësuar dhe miratuar kërkesën e KOSTT-it.
3. Ky vendim do të botohet nga KOSTT-i, brenda 5 ditë pune pas njoftimit të ZRRE-së dhe botimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
4. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
5. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e miratimit ose datës së publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
6. Ky Vendim hyn në fuqi datën e lëshimit ose datën e publikimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së

**Bashkangjitur:** Versionet e miratuara të Dispozitave Kalimtare për Kodin e Matjes dhe Kodin e Rrjetit.

**Bordi i ZRRE:**

\_\_\_\_\_  
Ali Hamiti, Kryesues

\_\_\_\_\_  
Theranda Beqiri, Anëtare

\_\_\_\_\_  
Naim Bejtullahu, Anëtar

\_\_\_\_\_  
Nysret Avdiu, Anëtar